



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 19 të Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JOFINANCIARE TË  
KOMUNËS

I. Për inventarizimin e pasurive jofinanciare të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje:

1. Burim Gashi, Drejtorati për Administratë, Kryesues
2. Gafurr Hetemi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Ramiz Gashi, DKRS, anëtar

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me Rregulloren nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon :

1. Të inventarizoj të gjithë pasurinë jofinanciare që është në pronësi dhe kontroll të Komunës,
2. Të bëj verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes të pasurisë jofinanciare ,
3. Të bëj krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jofinanciare,
4. Të identifikojë pasurinë që nuk ka vlerë të bartur,
5. Të identifikojë pasuritë e dëmtuara dhe jashtë përdorimit

III. Përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit

Komisioni pas kryerjes së inventarizimit duhet të hartoj dhe prezentoj raportin për inventarizimin e pasurisë jofinanciare më së largu deri me datë 15 Janar 2025.

IV. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e komisionit për inventarizimin e pasurisë e pasurisë jofinanciare të komunës 1Nr.020/04-46471 i datës 20.09.2024.

1Nr.020/04-46471/2  
Lipjan, më 26.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës, nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1  
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit shëndetësor për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale QKMF – Dr. Mehdi Zejnullahu – Lipjan Nr.03.111/01-33766 i datës 15.07.2024 si dhe konkursin Nr.03.111/01-35563 i datës 26.08.2024, në këtë përbërje:

1. Halil Vehapi, QKMF-Lipjan, Kryesues,
2. Valdete Muji, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare dhe
3. Besa Bislimi, Sektori për personel, anëtare

Neni 2  
Detyrat e punës

1. Detyrë e Komisionit të ankesave është shqyrtimi i ankesave për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale QKMF – Dr. Mehdi Zejnullahu – Lipjan Nr.03.111/01-33766 i datës 15.07.2024 si dhe konkursit Nr.03.111/01-35563 i datës 26.08.2024 dhe ka mandat të përkohshëm përkatësisht vlen vetëm për procedurat e konkurseve të cekur.
2. Komisioni shqyrton ankesën dhe publikon rerezultatit përfundimtar brenda 5 (pesë) ditëve dhe për secilën ankesë nxjerr vendim në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik si dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Neni 3  
Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet vendimi 1Nr.020/01-41668 i datës 20.08.2024.

1Nr.020/01-41668/2  
Lipjan, më 11.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe rekracionit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-39295 të datës 08.08.2024, në përbërje si vijon:

1. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Medina Publica, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ganimete Osmani, nga OJQ-të, anëtare
5. Fatbardha Drnogllava, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertës, anëtare dhe
6. Sanije Vuniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezerv

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe rekracionit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-39295 të datës 08.08.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.4020/04-46570 i datës 23.09.2024.

1Nr.020/04-46570/2  
Lipjan, më 30.09.2024

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për organizimin e aktivitetit të festivalit për fëmijë "Lipjani Këndon 2024" në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-40099 të datës 12.08.2024, në përbërje si vijon:

1. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ganimete Osmani, nga OJQ-të, anëtare
5. Fatbardha Drnogllava, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertes, anëtare dhe
6. Fadil Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar rezerv

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për organizimin e aktivitetit të festivalit për fëmijë "Lipjani Këndon 2024" në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-40099 të datës 12.08.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-46423  
Lipjan, më 19.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

## VENDIM

### MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – STRATEGJINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E LIPJANIT 2024-2029

#### Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Lipjanit 2024-2029

#### Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Lipjanit 2024-2029 ose në email adresën [valon.pacolli@rks-gov.net](mailto:valon.pacolli@rks-gov.net), më së largu me datë 26.09.2024.

#### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 300/01-45487  
Lipjan, më 11.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan, Br. 15-353-35739 dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

## ODLUKA

### O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT- STRATEGIJA LOKALNOG EKONOMSKOG RAZVOJA OPŠTINE LIPLJAN 2024-2029

#### Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- Strategija lokalnog ekonomskog razvoja Opštine Lipljan 2024-2029

#### Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Plan mogu se poslati Radnoj Komisiji za izradu Projekt- Strategija lokalnog ekonomskog razvoja Opštine Lipljan 2024-2029 na email adresu: valon.pacolli@rks-gov.net naj kasnije do 26.09.2024.

#### Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 300/01-45487  
Lipljan, 11.09.2024

PREDSEDNIK OPŠTINE

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

## VENDIM

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

#### Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **8,960.00€**, (tetë mijë e nënëtdhjetë e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/04-44270 e datës 03.09.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 32 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin gusht të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast  $32 \times 280 = 8,960.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

#### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhiorrolloarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

#### Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

INr.400/04-44270  
Lipjan, më 04.09.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

### VENDIM

#### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI PËRCAKTIMIN E POZICIONEVE PËR FURNIZIM ME KARTELA MBUSHËSE PËR TELEFONA MOBIL PËR VITIN 2024 1Nr.030/8-1192 I DATËS 05.01.2024

I. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet pika I e Vendimit mbi përcaktimin e pozicioneve për furnizim me kartela mbushëse për telefonat mobil për vitin 2024, 1Nr.030/8-1192 i datës 05.01.2024 si vijon:

Pika I – në pjesën tabelare pas numrit rendor 18 shtohen dy pozicione të reja me numrat rendor 19 dhe 20 me këtë përmbajtje :

Nr	Funksioni	Nr i Kryesve	Shuma mujore
19.	Numri për ekipin e kujdesit paliativ në QKMF	1	5 €
20.	Numri në recepcion për termine për kujdesin paliativ në QKMF	1	5 €

II.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohet Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Lipjan, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Menaxheri i Kontratës .

1Nr.030/8-1192/2  
Lipjan, më 18.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF - NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2023, Raportin - Procesverbalin e Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.5-404/01-36802 të datës 30.07.2024, duke vendosur sipas kërkesës së Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport Nr.01-404/01-44367 të datës 03.09.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr:

## VENDIM PËR SHITJEN E ASETEVE KOMUNALE JASHTË PËRDORIMIT

### Neni 1

Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Raportit - Procesverbalit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.5-404/01-36802 të datës 30.07.2024, do të bëhet shitja e aseteve - inventarit jashtë përdorimit në pronësi të komunës, me çmimin fillestar për hekur 0.08 € për kg, të cilat gjenden në kuadër të objektit të Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" në Lipjan, me shënimet si në tabelën në vijim:

Asetet e Vlerësuara:

Nr	Emri i paisjes	Sasia	Barkodi	Vlerësimi
1	Arka	1	KLyKKL1-1861	Jashtë funksionit
2	Stufë për ngrohje	1	KLyKKL1-1942	Jashtë funksionit
3	Stufë për ngrohje	1	KLyKKL1-1914	Jashtë funksionit
4	Stufë për ngrohje	1	---	Jashtë funksionit
5	Stufë për ngrohje	1	---	Jashtë funksionit
6	Rafta metal	1	KLyKKL1-7021	Jashtë funksionit
7	Rafta metal	1	KLyKKL1-7019	Jashtë funksionit
8	RAFT METALIK PËR ARKIVIMIN ME D 200X100X45VM	1	KLyKKL1-25043	Jashtë funksionit
9	Rafta metal	1	KLyKKL1-7022	Jashtë funksionit
10	Shkallë metalike	1	KLyKKL1-10235	Jashtë funksionit
11	RAFT METALIK PËR ARKIVIMIN ME D 200X100X45VM	1	KLyKKL1-25044	Jashtë funksionit
12	Orman metalik	1	KLyKKL1-1862	Jashtë funksionit
13	FOTOKOPJE Multifunction_High Volume Copy Machine	1	KLyKKL1-9977	Jashtë funksionit

14	Karrigë statike	1	KLyKKL1-1863	Jashtë funksionit
15	Karrigë lëvizëse (Lëkurë)	1	KLyKKL1-21162	Jashtë funksionit
16	Karrigë lëvizëse (Lëkurë)	1	KLyKKL1-21161	Jashtë funksionit
17	Karrigë lëvizëse (Lëkurë)	1	KLyKKL1-403	Jashtë funksionit
18	Furnizime dhe transporti i karriakave Standarde	1	KLyKKL1-21732	Jashtë funksionit
19	Karrigë statike	1	KLyKKL1-1940	Jashtë funksionit
20	Karrigë lëvizëse (Lëkurë)	1	KLyKKL1-21160	Jashtë funksionit
21	Karrigë statike	1	KLyKKL1-1913	Jashtë funksionit
22	Tavolinë	1	KDcKLP118-22907	Jashtë funksionit
23	Tavolinë	1	KLyKKL1-1859	Jashtë funksionit
24	Tavolinë	1	KLyKKL1-1860	Jashtë funksionit
25	Tavolinave me dim 160*90*72cm	1	KLyKKL1-21731	Jashtë funksionit
26	Tavolinë	1	KLyKKL1-813	Jashtë funksionit
27	Tavolinë e vogël	1	KLyKKL1-1923	Jashtë funksionit
28	Tavolinë (Për takime)	1	KLyKKL1-1922	Jashtë funksionit
29	Tavolinë	1	KLyKKL1-17551	Jashtë funksionit
30	Orman	1	KLyKKL1-1929	Jashtë funksionit
31	Orman me dy dyer	1	KLyKKL1-1934	Jashtë funksionit
32	Orman i hapur	1	KLyKKL1-1933	Jashtë funksionit
33	Rafta	1	KLyKKL1-1919	Jashtë funksionit
34	Rafta	1	KLyKKL1-1920	Jashtë funksionit
35	Rafta	1	KLyKKL1-1917	Jashtë funksionit
36	Rafta	1	KLyKKL1-1916	Jashtë funksionit
37	Sirtarë	1	KLyKKL1-17552	Jashtë funksionit
38	Varëse për rroba	1	KLyKKL1-1936	Jashtë funksionit
39	Varëse për rroba	1	KLyKKL1-21183	Jashtë funksionit
40	Varëse për rroba	1	KLyKKL1-1915	Jashtë funksionit
41	Kalldajë për ngrohje me dru	1	pa barkod	Jashtë funksionit
42	Radiator	33	pa barkod	Jashtë funksionit
43	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1829	Jashtë funksionit
44	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1830	Jashtë funksionit
45	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1832	Jashtë funksionit
46	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1833	Jashtë funksionit
47	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1834	Jashtë funksionit
48	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1835	Jashtë funksionit
49	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1836	Jashtë funksionit

50	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1837	Jashtë funksionit
51	Trafë -Shperndarës I rrymës	1	KLYKKL1-1838	Jashtë funksionit
52	Aparate kundër zjarit	7	pa barkod	Jashtë funksionit
53	Karrike për kino	353	pa barkod	Jashtë funksionit
54	Dyer hyrëse alumini	2	pa barkod	Jashtë funksionit
55	Dyer hyrëse plastike	1	pa barkod	Jashtë funksionit

### Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtorati për Prokurim.

### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Prokurim dhe Zyrtari për pasuri.

1Nr.404/01-44367

Lipjan, më 04.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 11 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për klubin Futbollistik "Gadimja" 15Nr.400/01-35821 i datës 25.07.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr

## V E N D I M PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

Me këtë Vendim i TRANSFEROHET shuma e mjeteve në vlerë prej 5000 €, ( pesë mijë euro), Klubit futbollistik "Gadimja" sipas kërkesës së tyre të datës 03.07.2024 dhe miratimit të Vendimit Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për Klubin futbollistik "Gadimja" 15Nr.400/01-35821 i datës 25.07.2024, me të cilin Vendim i është dhënë pëlqimi Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare me qëllim të subvencionimit dhe motivimit të lojtarëve të këtij klubi të ri të Komunës së Lipjanit në kuadër të cilt ka edhe grupmosha të reja U11, U13 dhe U15 të cilët edhe marin pjesë në gara kampionale

### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Klubit futbollistik "Gadimja" nr. 1300001200036364 në BPB.

### Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara Klubi Futbollistik duhet të sjellë Raport narrativ dhe financiar duke i bashkëngjitur edhe faturat dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu me datë 31.12.2024.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Klubi Futbollistik "Gadimja"

1Nr. 453/01-31650  
Lipjan, më 13.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

